

**AKT THEMELIMI**  
**PER KRIJIMIN E SHOQERISE**  
**ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**MATRIX KONSTRUKSION sh.p.k.**

Ne Tirane, sot ne date \_\_\_\_ 10. 1995 ne ortaket Arjan Leskaj banues ne Tirane Bujar Kaci banues ne Tirane, Gleni Meksi banues ne Tirane dhe Genti Agolli banues po ne Tirane, ne mbeshtetje te ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite "Tregtare" dhe te ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te vendosem qe te formulojme kete akt per themelimin e shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar "Matrix Konstruksion " sh. p. k. si me poshte:

**Neni 1**

Te formohet shoqeria tregetare private me pergjegjesi te kufizuar " Matrix Konstruksion " sh. p. k. Shoqeria do te kete seline e saj me vendqendrim ne Tirane , Rr. Shyqyri Berxolli, Lagjia 5, Nr 16. Ajo mund te hape vendqendrim te dyte, operative, filiale, perfaqesi dhe agjenci ne te gjitha territorin e vendit.

**Neni 2**

SHOQERIA vepron si person juridik menjehere mbas rregjistrimit ne organet perkatese ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me kete akt - themelimi , statutin e saj dhe ligjet e shtetit shqiptar. Palet mbajne pergjegjesi vetem per sa eshte nenshkruar.

**Neni 3**

SHOQERIA do te kete gjithashtu vaten e saj.  
Shoqeria krijohet per nje aktivitet kohe mbi 10 vjet. Ky afat mund te zgjatet.

**Neni 4**

Objekti i aktivitetit te shoqerise eshte ne fushen e :

Import eksport me shumice pakice te mallrave industriale e ushqimore, elektronike e radiotelevizive, bujqesore, blektoraleve e bimeve medicinale, te mallrave farmaceutike.

Import eksport per materiale ndertimi, prodhime elektromjekesore, per paisje spitalore e shkollore. Per te gjitha prodhimet hidraulike e hidrosanitare.

Import eksport ne fushen e karburanteve , vajrave lubrifikante ,alkooleve si dhe edo veprimtari tjeter tregtare qe te jete e ligjshme dhe e dobishme per veprimtarine e shoqerise.

Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe projektimit, per restaurimin e objekteve te vecanta kulturore ose te kultit . veprimtari imobiliare per shitje e blerje.

Veprimtari ne fushen e turizmit, bar-restorante, hotele etj.





#### **Neni 5**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke depozituar nga te kater ortaket ne masen 25 % secili (pra nga 250.000 lek secili )

#### **Neni 6**

Themeluesit mbajne te drejten e pronesise ne mjetet e investuara ne SHOQERI.

#### **Neni 7**

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- Asambleja e Ortakeve
- Administratori
- Komisioni i Revizionit

#### **Neni 8**

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i Shoqerise.

#### **Neni 9**

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise do te perbehet nga 4 veta.  
Ceshtjet e tjera nga veprimtaria e Asamblese se Ortakeve rregullohen hollesisht ne Statutin e Shoqerise.

#### **Neni 10**

Fonksionin drejtues ne Shoqeri e ushtron Administratori.

#### **Neni 11**

Administratorin e emeron dhe e shkarkon Asambleja e Ortakeve.

#### **Neni 12**

Komisioni i Revizionit perbehet nga 2 anetare te cilet zgjidhen nga vete ortaket.

#### **Neni 13**

Themeluesit e Shoqerise disponojne te drejten mbi fitimin qe realizon Shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj .  
Fitimi percaktohet ne bilancin vjetor te Shoqerise.





#### **Neni 14**

**Punetoret qe kane krijuar marredhenie te punes ne Shoqeri nuk marrin pjese ne shperndarjen e fitimit, po qe se ne kontraten e punes nuk parashikohet ndryshe.**

#### **Neni 15**

**Themeluesit mund te percaktojne me vendim te vecante qe uje pjese e caktuar e fitimit te perdoret per zgjerimin e bazes materiale te punes, perkatesisht per zhvillimin e metejshem te Shoqerise.**

#### **Neni 16**

**Pas likuidimit te taksave , tatimeve, ndarjes se mijeteve per pagat e punes se punonjesve te Shoqerise, mbetet ne dispozicion fitimi neto.**

**Fitimi neto qe u perket themeluesve , ndahet ne fund te vitit me daljen e bilancit vjetor ne raport me pjesemarrjen ne kapitalin themelues, pra :**

**Arjan Leskaj ne masen 25%**

**Bujar Kaci ne masen 25%**

**Gleni Meksi ne masen 25%**

**Genti Agolli ne masen 25%**

#### **Neni 17**

**Fitimi neto i Shoqerise ndahet:**

**- ne pjesen per ortaket e Shoqerise**

**- ne pjesen per zgjerimin e bazes materiale te punes, per zhvillimin e metejshem te saj.**

**- ne pjesen qe i shperndahet punonjesve , ne qofte se ne kontraten e punes eshte parapare qe ata te marrin pjese ne shperndarjen e fitimit te Shoqerise.**

#### **Neni 18**

**Mbas miratimit te bilancit vjetor dhe raportit financiar nga Themeluesit, pjese e fitimit qe u perket themeluesve mund te transferohet lirisht jashte shtetit shqiptar sipas Legjislacionit Shqiptar.**

#### **Neni 19**

**Kushtet dhe menytrat e themelimit dhe te nderprerjes se marredhenieve te punes , si dhe te drejtat , detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve rregullohen me kontraten e punes.**

#### **Neni 20**





#### Neni 20

Me kontratën e punës përcaktohen detyrimet e themeluesve ndaj punonjesve në Shoqëri.

#### Neni 21

Punonjësit në Shoqëri për punën e tyre marrin pagën vartësisht nga rezultatet e arritura në punë në përputhje me kontratën e punës.

#### Neni 22

Shoqëria do të shpërndahet në ato raste ku do të përcaktohen shprehimisht në statutin e saj.

#### Neni 23

Shoqëria mund të bashkohet me persona të tjerë juridike, të shkrihet në subjekt tjetër juridik dhe të ndahet në dy ose më shumë subjekte juridike vetëm me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

#### Neni 24

Shoqëria fiton zotesinë për të veruar me rregjistrimin në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

#### Neni 25

Cdo shtesë apo ndryshim i Kontrates do të bëhet me shkrim dhe me aprovimin e Asamblesë së Ortakëve.

#### Neni 26

Cdo mosmarreveshje që nuk mund të zgjidhet me bisedime ndërmjet Themeluesve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Tiranë sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 27

Ky akt themelimi u përpilua në katër kopje të njëjta për t'u përcjellë organeve kompetente njëra prej të cilave është nënshkruar në cdo fletë nga ortakët themelues do të mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "Matrix Konstruksion" sh.p.k. në Tiranë.

#### ORTAKËT

ARJAN LESKAJ

BUJAR KACI

GLENI MEKSI

GENTI AGOLLI





**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"MATRIX KONSTRUKSION" SH. P. K.**

Ne Tirane sot ne date 08.1995 ne ortaket

ARJAN LESKAJ i biri i Astritit, dtl. 1968 lindur e banues ne  
Tirane, Bul. Shqiperia e Re, p.6, sh.1, ap.16

BUJAR KACI i biri i Qemalit, dtl. 1966 lindur e banues ne Tirane ,rr. Shyqyri  
Bexholli, nr. 16

GLENI MEKSI i biri i Thomait dtl.1972, lindur e banues ne Tirane

GENTI AGOLLI i biri i Hysenit dtl.1964, lindur e banues ne Tirane ,Rr.Milhad  
Duri ,Nr.27

Ne mbeshtetje te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe  
ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per rregjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen  
plotesuar ne te " vendosem te miratojme kete statut baze per karakterin dhe  
veprimtarine e shoqerise tregtare private me pergjegjesi te kufizuar Matrix  
Konstruksion sh.p.k. si me poshte.

Neni 1

Themeluesit e permendur ne preambulen e ketij Statuti , themelojne Shoqerine  
me Pergjegjesi te Kufizuar Matrix Konstruksion sh.p.k. ne Tirane me kete Statut , ne  
perputhje me kontraten per krijimin e shoqese me pergjegjesi te kufizuar dhe me  
legjislacionon shqiptar. Ky Statut rregullon poziten juridike te bashkethemeluesve dhe  
te punonjesve te shoqerise , te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin  
dhe objektin e veprimtarise se shoqese dhe ceshnje te tjera me rendesi per punen e  
shoqerise.

Neni 2

Shoqeria eshte krijuar me kontraten per krijimin e Shoqese me Pergjegjesi te  
Kufizuar me mjetet vetijake te Themeluesve.

Neni 3



Shoqeria nga neni 1 i ketij statuti do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin  
Matrix Konstruksion sh.p.k. ne Tirane.

Neni 4

Shoqeria do te kete seline e saj me vendqendrim ne Tirane , Rr. Shyqyri  
Bexholli l. 5, nr 16. Ajo mund te hape vendqendrim te dyte, operative, filiale, perfaqesi  
dhe agjenci ne te gjitha territorin e vendit me vendimin e tre ortakeve.

Neni 5

Shoqeria ka statusin e personit juridik dhe ushtron veprimtarine e saj ekonomike  
te percaktuar ne kete statut per te realizuar fitim.







#### Neni 6

SHOQERIA do te kete gjithashtu vulen e saj dhe perdoret ne menyren dhe proceduren te cilat i percakton me shkrim administratori i shoqerise.

#### Neni 7

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje aktivitet kohe mbi 10 vjet duke filluar nga data e rregjistrimit te saj ne gjykate . Ky afat mund te zgjatet ose dhe te shkurtohet me vendim te ortakeve.

#### Neni 8

Objekti i shoqese eshte ne fushen e :

Import eksport me shumice pakice te mallrave industriale e ushqimore, elektronike e radiotelevizive, bujqesore, blektoraleve e bimeve medicinale, te mallrave farmaceutike.

Import eksport per materiale ndertimi, prodhime elektronjekesore, per paisje spitalore e shkollore. Per te gjitha prodhimet hidraulike e hidrosanitare.

Import eksport ne fushen e karburanteve , vajrave lubrifikante ,alkooleve si dhe cdo veprimtari tjeter trgetare qe te jete e ligjshme dhe e dobishme per veprimtarine e shoqerise.

Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe projektimit, per restaurimin e objekteve te vecanta kulturore ose te kultit . veprimtari imobiliare per shitje e blerje.

Veprimtari ne fushen e turizmit, bar-restorante, hotele etj.

#### Neni 9

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj te percaktuar ne kete statut ne territorin e Republikes se Shqiperise. Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te cele degjet dhe zyrat e saj te perfaqesimit ne perputhje me legjislacionin shqipetar.

#### Neni 10

Veprimtaria e shoqese, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete statut nuk mund te ndryshoje pa pelqimin e themeluesve.

#### Neni 11

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitim duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

Shoqeria i ka te gjitha te drejtat per veprimtarine juridike me te tretet.

#### Neni 12

Per detyrimet e veta shoqeria pergjigjet me tere pasurine e saj. Themeluesit nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise.



2

*[Faint handwritten signature]*



#### Neni 13

Themeluesit bartin rrezikun për veprimtarinë e shoqërisë në nivelin e shumës së mjeteve (kuotes) të dhëna me rastin e krijimit të saj.

#### Neni 14

Themeluesi i siguron mjetet për themelimin dhe fillimin e punës së shoqërisë në shumën prej 100 mijë lekë. Themeluesit rane dakort që pjesëmarrja e tyre në kapitalin themelues të shoqërisë të jetë si vijon:

Gleni MEKSI, person privat fizik vendas si aksioner përfaqëson kapitalin në para në shumën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë lekë) përkatësisht 25% të kuotes themeluese.

Arian LESKAJ person privat fizik vendas si aksioner përfaqëson kapitalin në para në shumën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë lekë) përkatësisht 25% të kuotes themeluese.

Bujar KACI person privat fizik vendas si aksioner përfaqëson kapitalin në para në shumën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë lekë) përkatësisht 25% të kuotes themeluese.

Genti AGOLLI person privat fizik vendas si aksioner përfaqëson kapitalin në para në shumën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë lekë) përkatësisht 25% të kuotes themeluese.

#### Neni 15

Mjetet nga neni 14 i këtij Statuti evidentohen me Librat Afariste të Shoqërisë.

#### Neni 16

Themeluesit, pjesët (kuotat) e tyre të kapitalit mund të a kalojnë të tretëve vetëm me pelqimin e themeluesit tjetër.

#### Neni 17

Shoqëria mund të plotësojë mjetet plotësuese me rregjistrimin e pjesëve (kuotave) të reja të kapitalit nga të tjerët që i aderojnë shoqërisë po që se me propozim të administratorit me këtë pajtohen themeluesit. Themeluesi i ri rregjistron pjesën (kuotën) e tij të kapitalit në mënyrën që e përcaktojnë drejtuesit e Shoqërisë.

#### Neni 18

Themeluesit mbajnë të drejtën e pronësisë në mjetet e investuara në shoqëri.



11  
1

Handwritten signature or initials at the bottom center of the page.



#### Neni 19

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e vet te prcaktuar ne kete Statut ne perputhje me kontraten per krijimin e shoqerise , me Legjislacionin shqiptar dhe me Statutin e saj.

#### Neni 20

Shoqeria kryen veprimtarine e saj me mjetet e investuara ne fondet e saj, me kredite e akorduara dhe me mjetet e tjera.

Shoqeria eshte e detyruar qe me vellimin e punes se vet te ushtroje varesisht nga shuma e mjeteve te investuara ne fondin themelor te Shoqerise dhe nga shuma e mjeteve te rezerves.

#### Neni 21

Shoqeria cakton fondet e meposhtme:

1-Fondin themelor

2-Fondin rezerve

Per ushtrimin e veprimtarise se vet ,Shoqeria mund te caktojte dhe fonde te tjera.

#### Neni 22

Fondi themelor i Shoqerise Formohet nga mjetet e investuara te Themeluesve dhe nga mjetet ne para te investuar nga persona te tjere.

#### Neni 23

Shoqeria shfrytezon fondin themelor per ushtrimin e veprimtarise se saj, per investimet ne fondet lokale, shoqerive dhe organizatave te tjera qe i ka formuar ajo si dhe per te mbuluar rreziqet pas shfrytezimit te mjeteve te rezerves.

Fondin Themelor , Shoqeria mund ta shfrytezoje dhe per destinacione te tjera ne perputhje me aktet e politikes se saj afariste.

#### Neni 24

Fondi rezeve i Shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit qe shoqeria realizon gjate veprimtarise se saj, qe percaktohet me nje vendim te vecante te Themeluesve.

Mjetet e fondit rezeve jane mjete vetijake te shoqerise dhe shfrytezohen per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.

Fondi rezerve mund te perdoret dhe per destinime te tjera ne perputhje me aktet e politikes se saj afariste.

#### Neni 25

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor nga Asambleja e Ortakëve ( Themeluesve ), pjese e fitimit neto qe u perket themeluesve mund te transferohet lirisht jashte shtetit shqiptar pa asnje kufizim.



74

75





Neni 26

Organet drejtuese te shoqerise jane :  
Asambleja e ortakeve :  
Administratori  
Komisioni i Revizionit

Neni 27

Asambleja e ortakeve eshte organi me ilarte dhe vendimor i shoqerise .

Neni 28

Asambleja e ortakeve te shoqerise do te perbehet nga tre vota :  
Kryetari i asamblese zgjidhet nga mbledhja e asamblese se ortakeve .  
Fillimisht si kryetari i asamblese caktohet Genti AGOLLI me nje mandat 1  
vjecar .

Neni 29

Asambleja e ortakeve ushtron keto pune :  
Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit dhe aktet e pergjithshme , vendimin  
per ndryshimin e emrit , selise dhe veprimtarise se shoqerise .  
Vendos per rritjen ose pakesimin e kapitalit themelor te shoqerise .  
Jep udhezime dhe synime te nevojeshme dhe orienton punen e Drejtorit (   
Administratorit ) te shoqerise .  
Miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar vjetor te shoqerise .  
Nxjerr statutin e shoqerise dhe percakton bazat e politikes afariste .  
Vendos per ndarjen dhe perdorimin e fitimit dhe per mbulimin e humbjeve dhe  
te rreziqeve .  
Vendos per ndryshimin e formes se organizimit te shoqerise /  
Vendos per pushimin ( mbylljen e shoqerise ) .  
Emeron dhe shkakton anetaret e komisionit te revizionit .  
Nxjerr rregulloren per punen e Asamblese se ortakeve .  
Drejton punet e tjera te rendesishme per afarizimin e shoqerise .

Neni 30

Asambleja e ortakeve mund te punoje dhe per ceshtje nga veprimtaria e saj  
mund te vendose ne menyre meritorie nese ne mbledhjen e asamblese eshte e  
pranueshme shumica e anetareve .

Neni 31

Asambleja e ortakeve punon dhe vendos ne mbledhje .  
Secili anetar i asamblese si perfaqesues i themeluesit ka ne asamble nje vote .  
Asambleja e ortakeve vendos me shumice votash te perfaqesuesve te  
themeluesve .





### Neni 32

Shoqeria ka administratorin i cili per punen e tij i pergjigjet asamblese se ortakeve .

Fillimisht administratore te shoqerise do te jene nga ortaket :

Arjan Leskaj dhe Gleni Meksi me nje mandat 1 vjecar me vendim te asamblese se ortakeve mund te hiqet njeri prej tyre dhe shoqeria te veproje me nje administrator .

### Neni 33

Administratorin e emerom dhe e shkarkon asambleja e ortakeve me propozim te njerit nga themeluesit .

### Neni 34

Mandati i administratorit eshte i kufizuar per nje periudhe jo me te vogel se nje vit . Administratori mund te rizgjidhet .

### Neni 35

Ne mungese apo ne pamundesi te ushtrimit te funksionit te administratorit ate e zevendeson administratori ose ortaku tjetet .

### Neni 36

Administratoret kryejne keto detyra :

Organizojne dhe drejtojne punen perkatesisht veprimtarine e shoqerise dhe afarizmin e saj .

Perfaqesojne shoqerine para te treteve .

Propozojne nxjerrjen e akteve nga kopetencat e asamblese te percaktuara ne nenin te ketij Statuti .

Propozon organizimin e shoqerise dhe cakton numrin dhe strukturen e kualifikimit te punonjesve .

Emerom dhe shkarkon shefat e sektoreve te shoqerise .

Lidh kontrata e kryen pune e veprime te tjera juridike brenda autorizimeve te asamblese se ortakeve .

Kryen te gjitha punet e shoqerise te cilat sipas ketij statuti nuk jane ne kopetence te asamblese se ortakeve perkatesisht te themeluesve .





#### Neni 37

Shoqeria ka komisionin e Revizionit.  
Komisioni i revizionot perbehet nga 2 anetare te cilet zgjidhen nga Themeluesit.  
Kryetari dhe anetaret zgjidhen per nje periudhe jo me shume se 2 vjet por me te drejte qe te mund te rizgjidhen.

#### Neni 38

Komisioni i Revizionit kontrollon veprimtarine e Shoqerise, te degeve dhe te perfaqesuesve te saj, sidomos ate financiare.  
Kryetari dhe anetaret e Komisionit te Revizionit ne kryetjen e detyrave jane te pavarur.

Komisioni i Revizionit eshte pergjegjes per veprimtarine e tij perpara Asamblese se Ortakeve dhe eshte i detyruar t'i paraqese asaj cdo vit raportin dhe kontrillet e bera, si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

#### Neni 39

Pas likuidimit te taksave ,tatimeve, ndarjes se mjeteve per pagat e punes se punonjesve te shoqerise mbetet ne dispozicion fitimi neto.  
Per shperndarjen e fitimit neto vendosin Ortaket ne Asamblene e tyre te ne fund te vitit financiar.

#### Neni 40

Fitimin e realizuar ,Themeluesit e ndajne ne perpjestime me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themelor te Shoqerise ne baze te Statutit e ne perputhje me Kontraten per krijimin e Shoqerise.

Punonjesit nuk marrin pjese ne shperndarjen e fitimit po qe se ne kontraten e punes nuk rregullohen ndryshe.

#### Neni 41

Fitimi neto i shoqerise ndahet :

-Ne pjesen per Ortaket dhe Shoqerise.

Ne pjesen per zgjerimin e bazes materiale te punes,per zhvillimin e metejshem te saj.

-Ne pjesen qe u shperndahet punonjesve nese me kontraten e punes eshte parapare qe ata te marrin pjese ne shperndarjen e fitimit te Shoqerise.

#### Neni 42

Themeluesit bashke me rrezikun per humbjet eventuale ne veprimtarine e Shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve ( kuotes ) se investuar me rastin e krijimit te saj.





Neni 43

Humbja mbulohet nga e tere pasuria e Shoqerise.

Neni 44

Nese Themeluesit nje here i kane mbuluar humbjet e Shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve ( kuotes ) se investuar me rastin e krijimit te saj, nuk jane te detyruar te bartin rrezikun per humbjet e metejshme.

Neni 45

Nese humbjet jane krijuar me fajin eskluziv te njerit prej themeluesve, atehere ai Themelues eshte i detyruar t'i mbuloje ato me mjetet e veta.

Neni 46

Neqoftese humbjet e Shoqerise nuk mund te mbulojen me mjetet e Themeluesve te dftua me rastin e krijimit te Shoqerise, ndaj Shoqerise hapet procedura e lijkujdimit, perkatesisht falimenti.

Neni 47

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me anen e njesive organizative te saj. Punonjesit ne Shoqeri varesisht nga lloji dhe natyra e punes qe bejne caktohen neper njesite organizative te saj. Njesite organizative jane sektoret. Keta dhe veprimtaria e tyre caktohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 48

Sektoret nuk kane status te Personit Juridik, as autorizime ne qarkullim juridik me te trete.

Neni 49

Ne sektor udheheq pergjegjesi ( shefi ) i sektorit. Per gjegjesin ( shefin ) e sektorit e emeron dhe e shkarkon Administratori i Shoqerise, me mendimin paraprak te Themeluesve. Ne punen e tij pergjegjesi ( shefi ) i sektorit pergjigjet para Administratorit te Shoqerise.

Neni 50

Marredheniet e punes ne Shoqeri rregullohen ne perputhje me kontraten per krijimin e Shoqerise, legjislacionin Shqiptar dhe kete Statut.



*[Faint, illegible text, likely bleed-through from the reverse side of the page]*





Neni 51

Ne kontraten e punes ne perputhje me legjislacionin e punes dhe me kontraten e punes kolektive rregullohen keto ceshtje :

- Kushtet dhe menyra e themelimitte marrdhenieve te punes.
- Fillimi i punes se punonjesit dhe caktimi i tij ne vendin e punes
- Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes,puna e nates dhe puna jashte orarit te punes,puna ne diten e pushimit javor dhe te festes zyrtare.
- Pushimet dhe mungesat te drejttat , detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.
- Nderprerja e marrdhenieve te punes.

Neni 52

Punonjesit ne Shoqeri per punen e tyre marrin page varesisht nga rezultatet e arritura ne pune ne perputhje me kontraten e punes.

Ne kontraten e punes caktohet paga e punes se punonjesit,shperblimi i pages dhe shperblimet e tjera.

Neni 53

Punonjesi eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e punimeve dhe zbatimin e detyrave ne menyre te ligjshme dhe profesioniste.

Neni 54

Administratori eshte pergjegjes per kryerjen e punimeve nga kompetenca e tij. Administratori,Shefi i Sektorit dhe punonjesit e tjere udheheqes bartin dhe pergjegjesine materiale per marrjen e veprimeve jo ligjore dhe te vendimeve me te cilat demtohet materialisht shoqeria dhe Themeluesit e saj,varesisht nga ndikimi i tyre per marrjen dhe zbatimin e vendimeve te tilla.

Neni 55

Shoqeria merr fund ;

- Ne rastet e percaktuara nge legjislacioni shqiptar.
- Kur Themeluesit vendosin t'i terheqin mjetet e investuara ne Shqiperi.
- Kur hapet procedura e likujdimit,perkatesisht falimentimit.

Neni 56

Me rastin e likujdimit te Shoqerise,Themeluesit marrin pjese ne ndarjen e pasurise se Shoqerise ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne pasurine e Shoqerise.



*[Faint, illegible handwritten text at the bottom of the page]*



Neni 57

Nese procedura e likujdimit te Shoqerise perfundon me humbje Themeluesit mbulojne humbjet nga kuotat e themelimit te dhena me rastin e krijimit te Shoqerise po qe se nje gje e tille nuk eshte bere me pare ne perputhje me nenet e ketij Statuti.

Neni 58

Nese ndonje humbje e meparshme e Shoqerise eshte mbuluar ne perputhje me nenet e ketij Statuti do te hapet procedura e falimentimit te Shoqerise.

Neni 59

Viti financiar i Shoqerise mbyllet me date 31.12 te cdo viti. Me kete rast administratori ben inventarin dhe llogarite vjetore sipas dispozitave per kontabilitetin dhe harton nje raport me shkrim per administrimin.

Bilancit i bashkohen :

- nje situacion per garancite e dhena nga Shoqeria
- nje situacion per sigurimet e bera nga Shoqeria

Neni 60

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin ne Gjykatën e Rrethit Tirane .

Neni 61

Cdo shtese apo ndryshim i Statutit do te behet me shkrim dhe me aprovimin e Asamblese se Ortakeve.

Neni 62

Propozimin per ndryshimet dhe plotesimet e Statutit mund t'i jape secili prej Themeluesve te Shoqerise.

Neni 63

Cdo mosmarrveshje qe nuk mund te zgjidhet me bisedime nepermjet Themeluesve do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Tirane sipas legjislescionit ne fuqi.

Neni 64

Te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, dohet referuar ne ligjin " Per shoqerite tregtare".





Neni 65

Kjo kontrate hyn ne fuqi daten e nxjerrjes dhe te nenshkruimit nga Themeluesit.

THEMELUESIT

Arjan Leskaj

Bujar Kaci

Gleni Meksi

Genti Agolli

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Dhoma e Noterise TIRANE

Nr. 5606 Rep

Nr. 1875 Kol

VERTETIM

Sot me daten 14/10/1995, para meje noteres u paraqiten Arjan Leskaj, Bujar Kaci, Gleni Meksi, Genti Agolli te cilet per identitetin e tyre u sigurova nga leternjofftimi, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se sa me siper e kane nenshkruar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, dhe une noterja e vertetetoj sipas ligjit.

